



ISP - Instituti i Politikave të Qëndrueshme

T: +355 69 99 13 820 E: info@isp-albania.org

Ad: Rezidenca Kodra e diellit,
Rruga e Jasmineve, Nd. 22, Nr. 170,
Tiranë, Shqipëri

KINOSTUDIO FRAME VEPRA TË PËRZGJEDHURA NGA FILMAT SHQIPTARË

7 - 26 shtator 2020 | Shtëpia Muze ISMAIL KADARE | GJIROKASTËR
Kurator Artan Shabani



KINOSTUDIO FRAME | VEPRA TË PËRZGJEDHURA NGA FILMAT SHQIPTARË"

Mbështetur nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me ISP Institutin e Politikave të Qëndrueshme, bën bashkë kryesisht artistët shqiptarë që kanë krijuar gjatë viteve të Kinostudios.

Është hera e parë që në shtepinë muze "Ismail Kadare" shfaqet një ekspozitë me vepra nga autorë si: Ksenofon Dilo, Shyqyri Sako, Dhimitër Theodhori, Kleo Nini, Billy Mazreku, Ben Kamili, Namik Prizreni, Myrteza Fushekati, Azis Karalliu, Bujar Luca, Astrit Tota dhe Sali Allmuça. Këta artistë kanë lënë një trashëgimi të madhe me veprat dedikuar personazheve nga filmat shqiptarë, peizazheve nga pjesët e xhirimit, portrete nga kërkimi i personazheve, kostumeve të larmishëm, skicave dhe realizimit të afishës së filmit shqiptar. Veprat e ekspozuara në hapësirat e Muzeumit "Ismail Kadare" tregojnë mënyrën si artistët kanë shpërfaqur personazhet e filmave dhe përshtatjen e skenave në filmat gjatë viteve të kinostudios. Fuqia e artit të shtatë është e lidhur ngushtë me atë art të krijuar gjatë atyre viteve.

Në këtë ekspozitë shfaqen piktorë, skenografë, skulptorë, kostumografë e grafistë, në veprat e tyre gjejmë personazhe të njohura të cilët kanë zënë një vend të rëndësishëm në arkivën e filmit shqiptar por veçanërisht në atë të publikut shqiptar.

Kinostudio Shqiptare ka lindur pas Luftës së Dytë Botërore dhe shumë shpejt drejtuesit e Shqipërisë komuniste e pikasën rëndësinë e veçantë dhe potencialin që kishte arti i kinemasë. Ky art gjatë sistemit komunist synonte edukimin e masave me vlerat nga të cilat e merrte frymëzimin vetë regjimi i kohës, revolucioni, komunizmi, mbrojtja, kombi, progresi etj. Kjo ideologji e cila ishte në të gjitha fushat e arteve pamore, e gjejmë në skulpturat monumentale, pllakatat e dikurshme të vendosura nëpër sheshet e qyteteve, bustet dhe shtatoret e shumta të cilat derdheshin në bronz dhe në beton, piktura, grafika, mozaikë, vizatime, deri tek punimet artistike me imazhe të spikatura enkas nga ideologjia e kohës.

Një pjesë e këtyre afisheve, vizatimeve, akuarelet dhe temperat, janë ekspozuar shumë rrallë dhe nuk janë parë asnjëherë nga publiku, prandaj është me shumë interes të zbulohet pasuria e afishës së ilustruar dhe punimet e tjera që plotësojnë këtë ekspozitë.

Gjatë periudhës 1953-1984, Kinostudio "Shqipëria e Re", së bashku me Radiotelevizionin Shqiptar prodhuan 174 filma artistikë të gjinive dhe metrazheve të ndryshme.

Në ekspozitën Kinostudio Frame sjellim qasjen bashkohore të artistëve Mazreku dhe Kamili, dy artistë që krijojnë midis Francës dhe Gjermanisë, veprat e tyre bashkohore janë një ri-vizitim që artistët bëjnë me filmin shqiptar, imazhet grafike nga ish- Kinostudio dhe ngacmimet e memorizuara nga shoqëria shqiptare.

Pak histori

Kontaktet e para me kinemanë ndodhën para se të fillonte prodhimi kinematografik, disa prej filmave filluan të qarkullonin falë përpjekjeve të artistit të njohur Kolë Idromeno (1860-1939), piktor, fotograf dhe urbanist i shquar. Gjatë vitit 1912 në banesën e Idromenos në Shkodër u hap salla e parë e kinemasë. Në vitet midis dy Luftrave Botërore filluan të funksiononin sallat e kinemasë dhe shfaqeshin filma me aktorët më të njohur të asaj periudhe.

Shqipëria në vitin 1927 kishte tetë salla kinemaje dhe nga fillimi i viteve 1930 sallat e kinemasë më të njohura në Shqipëri ishin: Nacional në Tiranë dhe Luksi e Majestik në qytetin e Korçës.

Xhirimet e para të kinemasë shqiptare ishin ngjarjet e rëndësishme të jetës qytetare, p.sh. Karnevalet e Korçës. Në vitin 1942 u prodhua filmi i parë shqiptar, një dokumentar nga Mihallaq Mone, titulluar "Bijtë e shqipes së Skënderbeut".

Në fund të vitit 1945, krijohet Agjencia Shqiptare e Filmave dhe në janar të 1946 shndërrohet në Ndërmarrje Shtetërore Kinematografike Shqiptare.

Në vitin 1952, inaugurohet Kinostudio Shqipëria e Re dhe që nga ajo periudhë e deri në fund të 1990 do të mbetej institucioni kryesor për prodhimin e filmave artistikë dhe vizatimorë, dokumentarëve të shumtë etj. Krijimi i parë artistik i Kinostudios është filmi Skënderbeu i cili erdhi si bashkëprodhim me MOSFILM të Moskës.

Sot shtëpia Muze Ismail Kadare mbështetur nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Institutin e Politikave të Qëndrueshme kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në ekspozitën " KINOSTUDIO FRAME \ VEPRATË PËRZGJEDHURA NGA FILMAT SHQIPTARË " Ekspozita do të çelet nga data 7 shtator dhe do të qëndrojë e hapur për publikun deri në datën 28 shtator 2020.

Shtëpia muze Ismail Kadare, Rruga Fato Berberi 16, Gjirokastrë

Për të dhënat historike janë shfrytëzuar librat e historianit të kinemasë Abaz T. Hoxha, "Enciklopedi e kinematografisë shqiptare", Botimet Toena, Tiranë 2002; "Kinematografia shqiptare 1985-2005", Botimet Toena, Tiranë 2004



Ksenofon Dilo 1961, "Debatik"
laps e karbon në letër kartoni 50 x 60 cm



Ksenofon Dilo 1961, "Debatik"
laps e karbon në letër kartoni 50 x 60 cm

Debatik

Përshkrimi: 1942. Tre vjet mbas pushtimit fashist, fëmijët krijojnë organizatën e fëmijëve anti fashistë që e quajtën Debatik. Coli, një djalë i varfër jetim pranohet në Debatik. Ai arrin të lajmërojë mësuesin komunist që është në kurth dhe vritet në një moment tensioni. Xha Demiri e gjen të vdekur dhe e merr në karrocë.

Operator: Dhimiter Anagnosti, Viktor Gjika

Bashkëpunëtorë: Gëzim Erebara, Grigor Ikonomi, Ksenofon Dilo, Vitori Celi, Koco Tollko, Ismail Balla, Vasil Lalo, Muharrem Fejzo, Llazar Kenuti, Llukan Bushi, Shyqyri Behri, Azis Karalliu, Marika Vila, Androniqi Vangjeli, Agim Verzivolli, Arif Matjani, Rifat Teqja, Todi Bozo

Aktorë: Dhimiter Pecani, Pullumb Dervishi, Shpetim Zani, Gjeraqina Osmanlliu, Roland Trebicka, Benhur Tila, Mario Ashiku, Skender Plasari, Luigjina Leka, Llazer Vlashi, Seit Boshnjaku, Gjon Karma, Sulejman Pitarka, Sander Prosi, Besim Levonja, Ndrek Shkjezi, Qenan Toro, Tonin Konçi, Dhionis Koçi, Ilia Shyti, Violeta Manushi, Mihal Stefa, Liza Vorfi, Dario Llukaçi, Zejnulla Hatibi, Llazar Morcka, Zihni Bega, Muharrem Fejzo, Drita Kallamata, Ndre Gjetani, Myzejen Luari.

Vlerësime: Filmi më i mirë në retrospektivën e filmit shqiptar në Festivalin e XV të Giffonit, Salerno, Itali 1985. U nderua me pllakë të veçantë të dhënë nga "Rotari Club" Salerno.

Regjia: Hysen Hakani

Skenari: Selman Vaqari, Niko Koleka, Hysen Hakani, Gëzim Erebara

Muzika: Tish Daija

Producent: Kinostudio Shqipëria e Re

Viti: 1961

Kohëzgjatja: 72 min



Ksenofon Dilo 1961 "Debatik" laps në letër 23 x 28 cm



Shyqiri Sako 1976 "Tomka dhe shokët e tij" laps në letër 33.5 x 24.8 cm

Tomka dhe shokët e tij

Përshkrimi: Tomka është një djalë i vogël që i pëlqen të luajë me top së bashku me shokët e tij. Por fushën e futbollit e marrin nazistët që kanë hyrë në qytet. Tomka, nën kujdesin e të rriturve, fillon të organizojë aksione kundër kampit ushtarak që është dislokuar në fushën e tyre të dikurshme të lojës.

Bashkëpunëtorë: Faruk Basha, Shyqiri Sako, Shpresa Papapavlo, Vangjel Leka

Aktorë: Enea Zhegu, Herion Mustafaraj, Genci Mosho, Artan Puto, Selma Sotillari, Flurans Ilia, Sotirag Çili, Pavlina Oça, Zehrudin Dokle, Xhelal Tafaj,

Vlerësime: Çmim të posaçëm në Festivalin e VIII Ndërkombëtar të Filmit për fëmijë e të rinj, së bashku me filmin "Beni ecën vetë" në Giffoni, Salerno, Itali 1978.

Regjia: Khanfize Keko

Skenari: Nasho Jorgaqi

Muzika: Aleksandër Lalo

Producent: Shqipëria e Re

Viti: 1977 Kohëzgjatja: 72 min



Billy Mazreku 2020, "Ura me tri harqe" gips 92 x 17 x 4 cm




Dhimiter Theodhori 1971, tre personazhe 35.1 x 25 cm




KINOSTUDIOJA «SHQIPERIA E RE»

“Beni ecën vetë” (1975)
Myrteza Fushekati 67x48 cm






"Një ditë në kantier" (1986) Liri Brahimi 20 x 35 cm



Lec Shkrel' 1967, laps në letër 20 x 30 cm



"Fillërojtësi" 1987, Shyqyri Sako 13.5 x 18 cm



"Filmi të mos heshtësh" Aziz Karalliu 35.2 x 24.9 cm

"Intendenti" (1981) Aziz Karalliu 47 x 68 cm

FILM ARTISTIK SHQIPTAR

SKENARI: SABRI GODO

REGJISOR: XHEZAIR DAFI

OPERATORE: ALEKO KASNECI, NIKO TRENI

PIKTOR: AZIS KARALLIU

KOMPOZITOR: KOZMA LARA

DREJTOR FILMI: ROBERT GJANI

INTERPRETOJNE

FITIM MAKASHI

ADEM GJYZELI

RESHAT ARBANA ARTISTI MERITOKR

PIRO MALAVECI

LUTFI HOXHA et.j

INTENDENTI

PRODHEM I KINOSTUDIOS "SHQIPERIA E RE", TIRANE 1980



"Rrugicat që kërkonin diell" Shyqyri Sako 1975,
tush në letër 13.2 x 17.5 cm



"Rrugicat që kërkonin diell" Shyqyri Sako 1975,
karbon në letër 31.9 x 22 cm

"Rrugicat që kërkonin diell" është një film shqiptar prodhim i vitit 1975 me dy pjesë: Regjisor: Saimir Kumburo & Rikard Ljarja, Skenari: Dhimitër Xhuvani, Producent: Shqipëria e re, Muzika: Kujtim Laro

Përmbajtja e filmit

Nebi Surreli së bashku me nënën jeton në varfëri të plotë. Duke kërkuar mundësi të ndryshme për të mbijetuar, punon si shpërndarës gazetash, hamall, dhe si transportues qymyri. Njihet me luftën në saj të Gaqos dhe shokë të tjerë të njesitit të qytetit. Ndiemonë në shpërndarjen e trakteve kur punon si gazetashitës, dhe në vështirësinë për transportimin e shtypshkronjës së njesitit. Urrejtja për Gani Herrin, tregtarin e qymyrit, i cili është edhe spiun i fashistëve, dhe ku edhe merë pjesë në ekzekutimin e tij.

Shyqyri Sako (Selenicë e pishës, Ersekë 05.03.1937)

Shyqyri Sako ishte pjesë e gjeneratës të artistëve që punuan në ish Kinostudion "Shqipëria e Re", si piktor filmi apo dhe piktor kostumogafë. Sako ka qenë piktor e mbi 40 filmave artistikë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në historinë e kinemasë shqiptare.

Pjesemmarjet e fundit të artistit Shyqyri Sako, Muzeumi Pera, Stamboll. Galeria Promenade Vlore, Shtëpia muze Ismail Kadare Gjirokaster



"Toka Jonë" Shyqyri Sako, karbon në letër 15.5 x 23.5 cm



"Toka Jonë" Shyqyri Sako, karbon në letër 23 x 34 cm



Shyqyri Sako, 1964 "Toka Jonë"
karbon në letër 23 x 34 cm

Përmbajtja e filmit[Redakto | Redakto nëpërmjet kodit]

Në një fshat në veri të Shqipërisë, reforma agrare i kthen tokën Lokes dhe familjes së saj, të cilën ia kishte përvetësuar me intriga Tuç Maku, një pronar i madh tokash në atë zonë. Fillon konflikti midis dy familjeve. Tuç Maku hakmerret duke vrarë Murrashin, djalin e Lokes, i cili ishte një nga aplikuesit e reformës agrare. Mbas kësaj tragjedie Lokja kthehet te fëmijët e saj, Leka dhe Filja.

"Trajtat muzikore luhaten mes vjetërsisë së rendit feudal dhe ankthit të tambureve të luftës dhe risisë, shoqëruar me tonalitete optimizmi lirik. Shoqëria e re i ka thyer kufijtë, muret dhe normat e individualizmit fisnor tradicional; i ka çelur tokën e re për t'u punuar, por malësori mbetet më i vetmuar se më parë, me një shtrëngesë të re tragjike, me farsën e të qenit i lumtur. Kuptimi i trishtimit, të cilit i referohemi në këtë analizë, i përket rendit artistik, poetik, lebetitjes së ndryshimit të shpejtë normativ, por aspak atij politik. Vjen përherë një kohë kur e vjetra dhe rikthimi kah saj është e papranueshme në të gjitha dimensionet, por kjo nuk e pengon njeriun të vajtojë apo të ligështohet për atë që nuk është më e që ndoshta nuk do të rikthehet. Veçse, përtej trishtimit emocional të malësorit, ndodhet një trishtim tjetër, madje një dialektikë trishtimesh."

Regjisor: Hysen Hakani

Skenari:Peçi Dado

Producent: Kinostudioja "Shqipëria e Re"

Muzika: Çesk Zadeja



Shyqyri Sako, 1964 "Toka Jonë" karbon në letër 23 x 34 cm

"Rrugë të bardha" Pastelë mbi letër 14.7 x 25.6 cm





Fundi i një gjakmarrjeje

Subjekti trajton realitetin gjatë regjimit zogist duke fajësuar përgjegjësit për përçarjen e popullit dhe nxitjen e hakmarrjes midis tyre. Dy të rinj Mazi dhe Dushi rrjedhin nga dy familje malësore që janë në gjak me njëra tjetrën prej shumë kohësh. Njëra familje jeton në malësitë e thella dhe tjetra në qytet.

"Rrugë të bardha" është një film shqiptar i prodhuar në vitin 1974. Regjia : Viktor Gjika.
Skenari : Vath Koreshi. Producent: Shqipëria e Re. Muzika : Limos Dizdari.
Përmbajtja e filmit

Një djalë i ri Deda i mbushur me entuziazmin e moshës dhe dashuri për punën endet përgjatë linjës telefonike duke kërkuar shkëputjen. Njerëzit që jetojnë në zona të thella malore presin me padurim të rregullohet linja e t'i urojnë njëri tjetrit Vitin e Ri. Deda vdes i ngrirë në majë të shtyllës duke luftuar me të ftohtin dhe motin e keq.




"Fund i një Gjakmarrjeje" , Miks në letër 25.6 x 14.7 cm



Azis Karalliu 1978, "Nusja dhe shtetrrëthimi" 67x47 cm



Alush Shima 1980 "Ne vinim nga lufta" 47 x 67 cm





Shyqyri Sako 1970, "Montatorja" 48 x 67 cm



Piktor Shyqyri Sako fragment



Kleo Nini 1978 "Dollia e dasmës sime" 47 x 67 cm

BEN KAMILI

"Loja e hijeve - filmi i para 1000 vitesh"
Apo Arti i hijeve
"Schattenspiel - Farbfilm vor 1000 Jahren?"



Guri Madhi në kinema Majestik
Korçë, viti 1938.



Në kinema me kolegun e shokun e tij Vangjo Manjati

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

- 30 P.A. 5 Nën një strehë që kullon nga oshu i ihtë e i vashovashen qendron Dritani, i cili bashkë me të vëllën e tij krahë qafe në ushqet. Dëgjohet shurma e një karroce - Per në pazar?- pyet Dritani. - Huj - përgjigjet karrosteri. drejt karroces.
- 35 P.A. 1,5 Dritani hap derën e karroces dhe hyn. Aty ndodhet Don Pali, shytur në leximin e librit të lashtëve.
- 40 P.A. 2 Don Pali qëndrohet duke i hedhur një sy Dritanit për pa i dhënë të njohur, vashon leximin.
- 41 P.A. 2 Dritani e ven re, rregullon torten dhe nëqesh. Karroca nisët.
- 42 P.A. 1,5 Karroçieri çrrek në këmbë kuaqte që është i mbuluar me një mushamë të zezë hedhur -Njo. Njo/ krahëve.
- 43 P.A. 1,5 Në anën e majtë të karroçierit varet një helmë gjermane me kukën poshtë, që asna duket që e përçor për të dhënë një kuaqve.
- 44 P.A. 2,5 Karroca eon ngadale, përmas sheshit të asfaltuar të lagur nga oshu. Tejt duket tanki i prishur.
- 45 P.A. 4 Dritani dhe prifti të përgjenduar sejcili në kondimet e vetë. Karroca ndalet. Prifti sgrihet.
- 46 P.A. 1 Prifti hap portën e karroces dhe dal.
- 47 P.K. 1 Dritani shikon
- 48 P.A. 4 Dëprej te xhanit të zezë në karroce duket prifti që i mbuluar nga qadra paguan karroçierin dhe shkon drejt kishës së madhe.
- 49 P.A. 5 Karroca eon në shpejtë pastaj ndalet tejt libraria e Sulltanit. Dritani shret paguan dhe hyn në librari. Karroca nisët. - Njo, Njo.



Boja e një karroce pajton



Sieja e karroces.



Troçellina e këpëve të kuaqve dhe shurma e karroces që eon.



Shurma e karroces që nisët.



Filmi "Komisari i Dritës" u prodhuar 1966 nga regjisori Dhimitër Anagnosti dhe Viktor Gjika,

Skenari: Llazar Siliqi, Producent: Shqipëria e re, Muzika: Tish Daija.

Përmbajtja e filmit

Çlirimi e gjeti Shqipërinë në padije dhe injorancë. Mbi 85 e popullsisë ishte analfabete. Luftëtari i brigadave partizane, Dritan Shkaba, ngarkohet me detyrë që të hapë shkolla në fshatrat e Mirditës krahinë malore në Shqipërinë e veriut. Mësuesi i ri duhet që krahas penës të shtrëngojë fort dhe pushkën. Rreth e rrotull veprojnë banda të armatosura të reaksionit, të cilat bëjnë gjithë përpjekjet për të penguar reformën arsimore në luftë kundër analfabetizmit.

"Komisari" është një film fetar me dy atmosfera: kundër zotave dhe korrupsionit të klerikut dhe pro besimit tek feja e re. Viti 1966 nuk është as zbritja e djallit komunist në tokën shqiptare dhe as perëndimi i zotave apo i çdo metafizike. Është rilindja e një feje të re, më të emancipuar, më revolucionare, më praktike dhe unifikuese."

Interpretojnë

Rikard Ljarja ... Dritan Shkaba

Roza Anagnosti ... Rudina

Ndrek Luca ... Prifti Dom Pali

Ndrek Prela ... Gjyshi i Dritanit

Prend Lekunda ... Doda, xhaxhai i Rudinës

Mihal Stefa ... Shërbyesi i Kishës

Reshat Arbana ... Nikoll Mustaqeziu

Noc Sheldia

Mark Kola ... Kryetari i Këshillit

Liza Vorfi ... Dava, gruaja e Prenkës

Mario Ashiku ... Ndre Gjetani

Fejzi Spahiu ... Komisari

Loro Kovaçi ... Plaku Baca

Viktor Zhusti ... Mark Denina

Antoneta Papapavli ... Ngjela

Vitore Nino ... Nëna e Pellumb Currit

Viktor Bruçeti

Todi Thanasi

Sulejman Dibra ... Partizani i Plagosur në shtëpine e Dodës gjatë luftës

Ermira Lika

Adrian Devolli

Murat Basha


Lazarin Mazreku

Gazmend Musaraj

Adriatik Bakiraj

Bardhyl Baholli

Aleksandër Naqi



Shyqyri Sako 1971, Në portin detar Durrës për filmin - **HORIZONTE TE HAPURA** 10.8 x 28.6 cm

Filmi bazohet në ngjarje reale. Në portin detar po punohet për vendosjen e bigës lundruese pas një rimonti. Urani, një vinçier i zoti caktohet të punojë në ekuipazhin e saj. Drejtoria e portit kërkon dihmën e ekuipazhit, për heqjen e disa kollonave betoni. Sokrati, shefi i planit, pengon punën e tij në rimont. Robert (me nofkën çamçakizi), një i ri i cili nuk ka një opinion të mirë, bëhet pengesë në dashurinë e Azemit dhe Artës. Në një ditë të stuhishme, për të ruajtur bigën Urani sakrifikon jetën e tij.

"Ndoshta është rastësi që binomi dashuri-uzinë, dashuri-mjet prodhimi, dashuri-bujqësi është i pranishëm në shumë filma të kohës. Dashuria dhe industrializimi i vendit ecin bashkë, veçse, sa më shumë përparon e sundon fabrika, aq më tepër dashuria (si ndjenjë-martësë) bëhet klishe qesharake për t'i bërë vend dashurisë-seks (si nevojë-çlirim). Është koha kur dashuria dhe uzina sintetizohen në kinema."



Kurator Artan Shabani